



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 1597 prot.

Himarë, më 23.06 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË

✓
Himarë

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 23, pika 12, nenit 54, pika “dh”, nenit 55 dhe nenit 64, pika “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, për marrëdhëniet e punës jashtë shërbimit civil, vendimit nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë; si dhe pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale, Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë dhe Drejtoria Juridike për kalimin e kopshtit në qendër, në shkollën “Pano Nikolla Meniko”, në shërbim me orar të plotë me drekë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”.
- Relacion: Mbi projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”.

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE
DIGJITALE

Nr. 4597/prot.
1

Himarë, më 23.06.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 42, Datë 23.06.2026

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 62, DATË 22.12.2025, TË KËSHILLIT
BASHKIAK HIMARË, “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË
PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 23, pika 12, nenit 54, pika “dh”, nenit 55 dhe nenit 64, pika “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, për marrëdhëniet e punës jashtë shërbimit civil, vendimit nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë; si dhe pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale, Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë dhe Drejtoria Juridike për kalimin e kopshtit në qendër, në shkollën “Pano Nikolla Meniko”, në shërbim me orar të plotë me drekë,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtimin e 6 (gjashtë) punonjësve për kopshtin në qendër, në varësi të shkollës “Pano Nikolla Meniko”, me qëllim kalimin e shërbimit nga kopsht pa drekë/me orar të reduktuar në kopsht me orar të plotë, me drekë dhe pushim ditor për fëmijët.
2. Miratimin e ndryshimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026, i cili do të jetë 339 punonjës.

3. Numri i administratës së bashkisë do të jetë 233 dhe numri i punonjësve të ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë nuk ndryshon dhe do të jetë 106.
4. Numri i punonjësve të kopshtit në qendër ndryshon nga 5 (pesë) punonjës në 11 (njëmbëdhjetë) punonjës.
5. Efekti financiar që rrjedh nga shtimi i numrit të punonjësve përballohet nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2026, sipas vendimit të veçantë për ndryshimet buxhetore dhe pasqyrave financiare përkatëse.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë që, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të miratojë me akt të veçantë ndryshimet në strukturën dhe organikën e Bashkisë Himarë për vitin 2026, në përputhje me numrin maksimal të punonjësve të miratuar me këtë vendim.
7. Ngarkohen drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë, drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve dhe institucioni arsimor përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar.

KRYETARI

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE
DIGJITALE

Nr. 1597/2 prot.

Himarë, më 23.06.2026

RELACION

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 62, DATË 22.12.2025, TË KËSHILLIT
BASHKIAK HIMARË, “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË
PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2026”**

Në mbështetjet të nenin 8, pika 2, nenin 23, pika 12, nenin 54, pika “dh”, nenin 55 dhe nenin 64, pika “j”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, për marrëdhëniet e punës jashtë shërbimit civil, vendimin nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”.

Bashkia Himarë ka vlerësuar nevojën për përmirësimin e shërbimit parashkollor në kopshtin në qendër, pranë shkollës “Pano Nikolla Meniko”, duke e kaluar këtë institucion nga shërbim pa drekë/me orar të reduktuar në shërbim me orar të plotë, me drekë dhe pushim ditor për fëmijët. Aktualisht, kopshti funksionon me 5 punonjës. Kjo strukturë personeli ka qenë e mjaftueshme për ofrimin e shërbimit me orar të kufizuar, por nuk mundëson funksionimin normal të një kopshti me drekë. Kalimi në shërbim me orar të plotë kërkon më shumë kohë kujdesi për fëmijët, mbulim më të gjatë edukativ, përgatitje dhe administrim të ushqimit, si dhe garantim të kushteve të higjienës gjatë gjithë ditës. Për këtë arsye, propozohet shtimi i 6 punonjësve të rinj për këtë kopsht, me qëllim që shërbimi i ri të funksionojë në mënyrë të rregullt, të sigurt dhe të qëndrueshme.

Kërkesa për shërbim parashkollor me orar të plotë është rritur ndjeshëm, veçanërisht për shkak të angazhimit të prindërve në punë dhe të dinamikës së jetës ekonomike e sociale në Bashkinë Himarë. Kjo nevojë bëhet edhe më e dukshme gjatë sezonit turistik, kur shumë familje janë të përfshira në aktivitete ekonomike me orare më të gjata. Shërbimi aktual pa

drekë nuk u përgjigjet plotësisht nevojave të prindërve që punojnë dhe kanë nevojë për një shërbim më të gjatë dhe më të organizuar për fëmijët e tyre. Ofrimi i drekës dhe qëndrimi i fëmijëve për një kohë më të gjatë në kopsht ndihmon familjet në organizimin e jetës së përditshme dhe krijon kushte më të mira për pjesëmarrjen e prindërve në tregun e punës.

Nga ana tjetër, për fëmijët, kopshti me drekë krijon mundësi për një ditë më të strukturuar, që përfshin proces edukativ, ushqim, pushim dhe kujdes të vazhdueshëm. Kopshti në qendër, pranë shkollës “Pano Nikolla Meniko”, aktualisht ka 5 punonjës. Me këtë numër punonjësish mund të mbulohet një shërbim i kufizuar, por jo një shërbim i plotë ditor me ushqim. Kalimi në kopsht me drekë kërkon domosdoshmërisht shtimin e personelit, sepse shtohen disa funksione të reja që aktualisht nuk mbulohen nga struktura ekzistuese. Konkretisht, nevojitet personel shtesë për:

- mbulimin e orarit të zgjatur edukativ;
- kujdesin ndaj fëmijëve gjatë kohës së ushqimit dhe pushimit;
- përgatitjen e ushqimit;
- ndihmën në kuzhinë dhe shpërndarjen e ushqimit;
- pastrimin, higjienën dhe mirëmbajtjen e ambienteve gjatë gjithë ditës.

Për këtë arsye propozohet që numri i punonjësve të kopshtit të rritet nga 5 në 11 punonjës. Shtesa prej 6 punonjësish propozohet të jetë si më poshtë:

- 1 përgjegjëse sektori
- 2 kujdestare;
- 1 sanitare;
- 1 kuzhinierë;
- 1 ndihmëse kuzhinierë.

Kjo shtesë është e nevojshme për të garantuar jo vetëm ofrimin e drekës, por edhe funksionimin normal të kopshtit me orar të plotë, në kushte të përshtatshme edukative, higjieno-sanitare dhe organizative. Me Vendimin nr. 62, datë 22.12.2025, Këshilli Bashkiak Himarë ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026.

Sipas këtij vendimi, numri i miratuar është:

- 333 punonjës gjithsej;
- 227 punonjës në administratën e Bashkisë Himarë;
- 106 punonjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Himarë.

Meqenëse shtesa prej 6 punonjësish do të destinohet për kopshtin në qendër, pranë shkollës “Pano Nikolla Meniko”, propozohet që numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Himarë të rritet nga 333 në 339 punonjës, ndërsa numri i punonjësve të administratës të rritet nga 227 në 233 punonjës. Numri i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë nuk ndryshon.

Pasqyra e ndryshimit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Numri i miratuar me VKB nr. 62, datë 22.12.2025	Shtesa	Numri pas ndryshimit
Numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Himarë	333	+6	339
Administrata e Bashkisë Himarë	227	+6	233
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë	106	0	106

Efekti konkret i kësaj shtese në shërbimin parashkollor është si më poshtë:

Institucioni/shërbimi ku shtohet personeli	Numri aktual i punonjësve	Shtesa	Numri pas ndryshimit
Kopshti në qendër, pranë shkollës “Pano Nikolla Meniko”	5	+6	11

Shtesa prej 5 punonjësish përfshihet në numrin e punonjësve të administratës së Bashkisë Himarë dhe ka si qëllim të vetëm funksionimin e kopshtit në qendër si kopsht me orar të plotë dhe me shërbim dreke. Shtimi i numrit të punonjësve sjell efekt financiar në buxhetin e Bashkisë Himarë për vitin 2026. Ky efekt lidhet kryesisht me shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore për 6 punonjësit shtesë. Gjithashtu, kalimi i kopshtit në shërbim me drekë kërkon edhe mbështetje buxhetore për shpenzimet e funksionimit të përditshëm, si ushqimi për fëmijët, materiale pastrimi dhe higjienë, energji, ujë, mirëmbajtje, pajisje kuzhine, mobilim dhe përshtatje të ambienteve sipas nevojës.

Për këtë arsye, miratimi i shtesës së punonjësve duhet të shoqërohet edhe me vendimin përkatës për ndryshimet në buxhetin e Bashkisë Himarë për vitin 2026. Efekti financiar do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Himarë, sipas pasqyrave financiare të përgatitura nga Drejtoria e Financës, Planifikimit të Buxhetit dhe Menaxhimit të Aseteve. Këshilli Bashkiak ka kompetencën për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të institucioneve/njësive buxhetore në varësi, ndërsa Kryetari i Bashkisë, pas miratimit të këtij numri, miraton ndryshimet përkatëse në strukturë dhe organikë.

Kalimi i kopshtit në qendër, pranë shkollës “Pano Nikolla Meniko”, në shërbim me orar të plotë dhe me drekë është një masë e nevojshme për përmirësimin e shërbimit parashkollor në Bashkinë Himarë. Ky ndryshim i përgjigjet kërkesave të familjeve për një shërbim më të gjatë dhe më të plotë për fëmijët, mbështet prindërit që punojnë dhe krijojnë kushte më të mira për kujdesin, edukimin, ushqimin dhe pushimin ditor të fëmijëve.

Për të bërë të mundur funksionimin real të këtij shërbimi, është i domosdoshëm shtimi i 6 punonjësve në kopshtin në qendër. Për këtë arsye, propozohet ndryshimi i Vendimit nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, duke rritur numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë nga 333 në 339 punonjës. Për sa më sipër, kërkohet shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli Bashkiak Himarë i projektvendimit “Për një ndryshim në Vendimin nr. 62, datë 22.12.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, ‘Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026’.

DREJTORIA E DBNJISHD

Ergis Papaproko



DREJTORIA E ÇSA

Aida Halilaj



DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj

